



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 6.5.2023

Nr: 460

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË MISIONIT TË VËZHGIMIT TË OSBE - ODIHR, TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË AMBASADAVE BULLGARE, SLOVAKE DHE GJERMANE, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot në datën 6.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesat me:

- KËRKUES:**
- Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR, me adresë Mak Albania Hotel, Sheshi "Italia", Tiranë dhe me përfaqësuese znj. Audrey Glover;
  - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, me adresë Rruga "Migjeni", nr. 21, 10000 Prishtinë dhe me përfaqësues z. Kreshnik Radoniqi;
  - Ambasada Bullgare, me adresë Rruga "Skënderbej", nr. 12, Tiranë dhe me përfaqësues z. Ivaylo Kirovz;
  - Ambasada Sllovaqe, me adresë Rruga "Skënderbej", nr. 8, Tiranë dhe me përfaqësues z. Peter Spisiak;
  - Ambasada Gjermane, me adresë Rruga "Skënderbej", nr. 9, Tiranë dhe me përfaqësues z. Peter Zingraf;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi i përfaqësuesve të ambasadave për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Data: 6.5.2023 Nr: 460  
Ora: 12:30



"Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE – ODIHR, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, të Ambasadave Bullgare, Sllovaqe dhe Gjermane, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

## V Ë R E J:

Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) vëzhgues afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyes si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Misioni i Vëzhgimit të OSBE/ODIHR është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 20 (njëzetë) vëzhgues afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Bullgare i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 2 (dy) vëzhgues afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Bullgare është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Sllovaqe i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 1 (një) vëzhgues afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyes, si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Sllovaqe është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada Gjermane i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për 3 (tre) vëzhgues afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyes, si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada Gjermane është subjekt, i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje, përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S:

1. Akreditimin e 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve të Misionit të Vëzhgimit të OSBE/ODIHR të për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin e 20 (njëzetë) vëzhguesve afatshkurtër të KQZ-së së Republikës së Kosovës për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër të Ambasadës Bullgare për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi të Ambasadës Sllovaqe për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve të Ambasadës Gjermane për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 6.5.2023 Nr: 460  
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin e kërkesave të Misionit të Vëzhgimit të OSBE – ODIHR, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës, të Ambasadave Bullgare, Sllovaqe dhe Gjermane, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”